



KONTROLLI I LARTË I SHETIT KRYETARI

Nr. 1191/11 Prot.

Tiranë, më 13.06.2017

V E N D I M

Nr. 61, datë 13.06.2017

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES DHE NJËSITË E VARËSISË, ME OBJEKT: “AUDITIMIN
E PËRPUTHSHMËRISË”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet dhe observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Mbi përputhshmërinë” së bashku me Opinionin e Auditimit, të ushtruar në “Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe njërive të varësisë” Tiranë, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2016 të veprimtarisë së këtij institucioni.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESVE:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200¹) e shpenzimeve:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë², sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në:

1. Hartimin e PBA 2015-2017 dhe PBA 2016-2018 për investimet: Duke ndryshuar programimi nga faza në fazë e kostos për njësi pa një justifikim të arsyeshëm;
2. Ndryshimet e planit të shpenzimeve buxhetore për investimet, për të dy vitet, por sidomos në vitin 2016, janë shumë të mëdha. Kështu shpenzimet për investime janë çelur 3.2 herë më shumë se një vit më parë dhe janë pakësuar në total gjatë vitit 2016 me 44.2% më pak se çelja e investimeve, ndryshime, që tregojnë se investimet planifikohen fillimisht në mënyrë optimiste e pa projekte të mirë studjuara. Në të gjitha programet vlera e investimeve ndryshon nga njëra fazë në fazën tjetër të programimit, si edhe gjatë vitit buxhetor në mënyrë të konsiderueshme, duke humbur kështu kuptimin e programimit në funksion të prioriteteve.
3. Aktivitetet e Qëndrueshme: mungesa e nxjerrjes jashtë përdorimit të aseteve në aparatet e këtij institucioni, rrit riskun e një pamje jo të drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme në Pasqyrat Financiare.
4. Prokurime të realizuara jo në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik. Kryesisht për sa i përket realizimit të qëllimit të rritjes së ekonomicitetit dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike.
5. Administrimi i pasurisë publike dhe evidenca kontabël e saj: Veprimtaria jo në përputhje me dispozitat nënligjore të MZHETTS, në cilësinë e pronarit, në dhënien e pronës publike me qira ka rrisur të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe qëllimin final për të cilin kanë dalë këto akte.
6. Moskoordinimi institucional dhe mosadministrimi i dokumentacionit të plotë nga MZHETTS dhe strukturat e saj vartëse, si ministria përgjegjëse për pasurinë publike, ka sjellë moskryerjen në mënyrën e duhur të monitorimit, raportimit dhe marrjes së masave me qëllim përmirësimin e gjendjes në për koncesionet e dhëna ndër vite.

Konkluzion/Opinion:

Nga auditimi i ligjshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinionit të kualifikuar**.

¹ **1.ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

2.ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare

B. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE:

1. Nga auditimi në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve(ATRAKO), *për zbatimin e ligjshmërisë në evidentimin e koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat*, konstatohet se, deri më tani nga Këshilli i Ministrave nuk është hartuar e miratuar një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësor për investime, të bazuara te partneriteti publik privat, të formave të preferuara të partneritetit publik privat dhe çështje të tjera që lidhen me kuadrin e përgjithshëm të politikave për koncesionet, kërkesë e nenit 8, pika 5 e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP”, i ndryshuar.

Gjithashtu, konstatohet se edhe ministria përgjegjëse për ekonominë (MZHETTS), si institucioni përgjegjës, sipas nenit 9/1 të Ligjit të koncesioneve/ppp, nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut dhe propozime prej saj, edhe pse duhet të orientojë dhe harmonizojë veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/ppp.

Nga auditimi konstatohet se, nga strukturat e shtetit (Autoriteti Kontraktor) nuk ka një bashkëpunim të mirë në drejtim të identifikimit të projekteve, publikimit dhe monitorimit të tyre dhe këtu kemi parasysh jo vetëm veprimtarinë para Marsit 2016 (kohë kur ka dalë VKM nr. 211, datë 16.03.2016) por për të gjithë periudhën e mëparshme. Kjo punë do të kishte bërë të mundur realizimin jo vetëm të një regjistri të detajuar dhe të një monitorimi korrekt, por Qeveria shqiptare me eksperiencën e deritanishme në këtë fushë (tepër të debatuar) duhet të kishte tashmë një strategji të detajuar politikash në fushën e koncesioneve/ppp.

ATRAKO në këtë veprimtari është vetëm një hallkë në këtë zinxhir institucionesh që mbulojnë këtë proces, e për pasojë dhe veprimtaria e saj është fragmentare duke pasur parasysh dhe varësinë institucionale të saj nga MZHETTS. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Në kuadër të hartimit të strategjisë së politikave dhe përcaktimin e sektorëve parësorë të zhvillimit të koncesioneve/ppp dhe në kuadër të miratimit (në proces) të Projekt Vendimit të KM “Për funksionimin e ATRAKO” nga ana e MZHETTS, ky institucion duhet të realizojë, të rivlerësojë, e të kërkojë rregullimin e varësisë institucionale dhe kompetencat funksionale të këtij institucioni, me qëllim realizimin sa më të mirë të misionit për të cilën është krijuar duke parashikuar që ATRAKO të funksionojë në rolin e një agjencie monitorimi duke pasur varësi nga Kryeministri.

Shtator 2017

2. Nga auditimi dokumentacionit të shoqërive për marrje me qira të pasurisë publike, u konstatua se, favorizimi i tyre nëpërmjet kontratave simbolike favorizuese “1 Euro”, është i paargumentuar dhe i pajustificuar, me tregues, teknikë, ekonomiko-financiarë, dhe tregues të tjerë që lidhen e burimet e punësimit, e konkretisht:

-Nuk ka të dhëna për prodhimin vjetor, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimin vjetor me qëllim garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të çdo shoqërie të interesuar për marrje me qira të pasurisë publike, madje duhet theksuar se edhe në një rast është lidhur kontratë favorizuese me “1 Euro” në një kohë kur kjo shoqëri deklaroi se ka një aktivitet të konsoliduar dhe fitim të akumuluar në fund të vitit 2015 në shumën prej 319,2 milionë lekë, çka tregon se nuk ka një përcaktim të saktë të shoqërive që duhen favorizuar me kontrata simbolike “1 Euro”;

-Nuk ka të dhëna apo tregues për burimin e financimit të investimeve, makineri, pajisjeve dhe ambienteve të tjera të shërbimit për trajtim të punëtorëve në se do sigurohen nga fitimi i aktivitetit ekzistues, apo me kredi bankare për të qenë të besueshëm në realizimin e shpenzimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës si kusht për përfitim të kontratës

favorizuese “1 Euro”, duke lenë shteg për përdorim të mjeteve financiare jashtë kanaleve të bankës.

-Nuk ka të dhëna për aktivitetin aktual të subjekteve që kërkojnë të zgjerojnë prodhimin nëpërmjet objekteve shtesë si, treguesit ekonomikë, prodhimin e realizuar, koston për njësi shpenzimet e prodhimit dhe të ardhurat nga shitja, për të garantuar vazhdimësinë e treguesve pozitivë ekonomikë edhe në kontratën e re me kushte favorizuese “1 Euro”;

-Plan bizneset e shoqërive nuk janë të shoqëruar me treguesit e punësimit dhe të dhëna demografike për popullsinë e zonës dhe shkallën e papunësisë si një burim potencial për të garantuar numrin e fuqisë punëtore në objektin që kërkohet të merret me qira për zhvillim apo zgjerim aktiviteti.

- Nga auditimi konstatohet se në 7 raste është shpallur fitues subjekti i vetëm konkurrues, të cilët kanë deklaruar se do kryejnë investime tepër minimale që variojnë nga 2.8 deri 31 % të vlerës së përcaktuar në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, duke mos justifikuar dhe argumentuar në këtë mënyrë edhe çeljen e vendeve të reja të punës.

Mangësitë e mësipërme nuk justifikojnë propozimet dhe miratimet e kontratave favorizuese simbolike “1 Euro”, pasi nuk janë argumentuar me vlerën e investimeve, treguesit ekonomik-financiarë, burimet e financimit të investimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga 10 shoqëri dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 2,466,681,000 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

a. Me qëllim që numri i të punësuarve të jetë në funksion të drejtë me kryerjen e investimeve për ti shërbyer përmirësimit të procedurave të dhënies me qira të pronës publike, por edhe garantimit të punësimit nëpërmjet investimeve të kryera nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes të marren masa të menjëhershme për inicimin e ndryshimit në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kreu V, “Kontrata me tarifën simbolike 1 Euro/kontrata”, ku të përcaktohet që:“.... kriterë vlerësuese bazë të jenë të dy kategoritë, respektivisht: Investimet dhe numri i të punësuarve, si kriterë në harmoni me njëri tjetrin”.

b. Krahas masave për ndryshimin e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, MZHETTS në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, të hartojë dhe miratojë një udhëzim të veçantë për dhënien me qira të pasurisë publike, ku të përcaktohen edhe disa kriterë të tjera e konkretisht:

Të bëhet vlerësimi i trualtit dhe e objektit e ku niveli i investimeve duhet detyrimisht të jetë mbi 200 për qind të vlerës së pasurisë së shpallur për konkurrim”;

Krahas të dhënave të mësipërme shoqëritë duhet të deklarojnë burimet e financimit të investimeve, me qëllim mospërdorimin e mjeteve monetare jashtë kanaleve të bankave;

Programet ekonomike, krahas treguesve ekonomike të shoqërohen edhe me tregues financiarë, si prodhimi i realizuar, kosto për njësi, shpenzimet e prodhimit, të ardhurat nga shitja, të dhëna demografike për popullsinë e zonës dhe shkallën e papunësisë si një burim potencial për sigurimin e fuqisë punëtore në objektin që kërkohet të merret me qira për zhvillim apo zgjerim aktiviteti, për të garantuar vazhdimësinë e treguesve pozitivë ekonomikë edhe në kontratën e re me kushte favorizuese “1 Euro”.

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i Programimit të **PBA 2015-2017 dhe PBA 2016-2018**, rezultoi se: është përgatitur nga grupet e menaxhimit të programeve në të dy fazat e programimit në kohë, por programimi me produkte ka mangësi në të dy periudhat e PBA: në llogaritjen e kostos së tyre, në përpilimin e fishave të projekteve dhe në gabime të konstatuara në tabelat e shpenzimeve me artikuj në disa institucione. Kështu, në shumë produkte, ka ndryshime të theksuara në vlerë nga faza e dytë në fazën e parë të programimit, megjithëse sasia e produkteve nuk ndryshon. Pra programuar me kosto të dyfishuar, apo të përgjysmuar duke e krahasuar me fazën e parë të programimit, gjë e cila tregon për plotësimin dhe llogaritjen e PBA-së në mënyrë formale, e të pa korigjuar as nga Drejtoria e Financës dhe as nga Ministria e Financës/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Kështu në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”/Aparati i MZHETTS, programimi me produkte është bërë për vitin 2016 në të dy fazat e PBA 2016-2018, me ndryshime të pa justifikuara në vlerë, si rrjedhim dhe në ndryshime të kostos për njësi, janë edhe 2 programet e tjera të MZHETTS, si programi “Zhvillimit ekonomik” dhe në programin “Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut dhe Infrastrukturën”, ndërsa për programin e “Zhvillimit të Turizmit”, nuk bëjmë dot krahasime me produkte me fazën e parë, sepse nuk është programuar në këtë fazë me produkte. Në shpjegimet e Drejtorisë së Financës është sqaruar se: *“..bazuar në kërkesat buxhetore të institucioneve, në prioritetet e reja për zhvillimin e Sektorit të Turizmit, si një nga prioritetet e Qeverisë, mbështetur në Tavanet e reja buxhetore, për të përmbushur këto prioritetet dërguar nga Ministria e Financave, nga Ekipi për Menaxhimin e këtij Programi, në koordinim me Drejtorinë e Financës, **u rikonceptua dhe u përgatit PBA 2016-2018, Faza II-të Politikat, Qëllimet, Objektivat si dhe Produktet dhe Aktivitetet e lidhura me to për këtë program**”* (Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni, Grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtoria e Financës, në zbatim të Ligjit organik të buxhetit, Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, të hartojnë, kontrollojnë Programimin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe projekt buxhetet vjetore, jo vetëm në kohë, por të plotësuar me të gjithë elementet ligjorë, ekonomike dhe financiare, duke relatuar në çdo fazë të programimit në Ministrinë e Financës, ndryshimet e justifikuara, (shitesat apo pakësimet), në përshtatje me ndryshimet e strategjive sektoriale, duke zbatuar penalitete për struktura që nuk i zbatojnë dhe shkelin legjislacionin për këtë qëllim.

Vazhdimisht

2. Aprovimi i projekt buxhetit për vitin 2016, në vlerë 2,781,994 mijë lekë, ka një ndryshim nga faza e dytë e programimit të PBA 2016-2018 për 473,094 mijë lekë, ose 20.5% më shumë, ndërsa kërkesat shtesë të fazës së dytë të programimit janë për 2,521,200 mijë lekë, pra janë aprovuar mbi kërkesat shtesë vlera prej 260,794 mijë lekë, pa pasur fisha projektesh të miratuara nga grupet e menaxhimit të programeve për këtë vlerë, apo pa patur një shpjegim në relacionin dhe në raportin e monitorimit, gjë e cila tregon se fondet shtohen, ose pakësohen pa dokumentacion, fisha apo projekte të hartuara nga grupet e menaxhimit të programeve (Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni, Grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtoria e Financës, në zbatim të Ligjit organik të buxhetit dhe Ligjit të Menaxhimit Financiar, të justifikojnë shumat e aprovimit të buxheteve vjetore mbi kërkesat shtesë të institucionit me dokumentacion justifikues (fisha projektesh, dhe relacione shpjeguese për domosdoshmërinë e shtimit, apo pakësimit të fondeve të programuara), duke relatuar në Ministrinë e Financës, në përshtatje me ndryshimet e strategjive kombëtare të këtij sektori.

Vazhdimisht

3. Ndryshimet e planit të shpenzimeve buxhetore, për të dy vitet, por sidomos në vitin 2016 për investimet janë shumë të mëdha, kështu: shpenzimet për investime janë çelur në vlerë 1,803,094 mijë lekë, nga 557,839 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo çelur 3.2 herë më shumë; janë pakësuar në total gjatë vitit 2016 për 797,856 mijë lekë (e ndarë për 194,856 mijë lekë financim i brendshëm dhe 603,000 mijë lekë investim i huaj), apo 44.2% më pak se celja; janë realizuar në vlerë 852,825 mijë lekë, pra janë realizuar 19% më pak se plani i ndryshuar, apo realizuar për 47.3%, krahasuar me planin fillestar, ndryshime që tregojnë se investimet planifikohen fillimisht në mënyrë optimiste e pa projekte të mirë studjuara. Në të gjitha programet vlera e investimeve ndryshon nga faza në fazën tjetër të programimit, por edhe gjatë vitit buxhetor në mënyrë të konsiderueshme, duke humbur kështu kuptimin e programimit në funksion të prioriteteve (*Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni dhe Drejtoria e Financës, në zbatim të ligjit organik të buxhetit dhe ligjit të Menaxhimit Financiar, të justifikojnë shumat e ndryshimeve të buxheteve gjatë vitit me dokumentacion justifikues (kërkesën e institucionit, miratimin nga grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtorisë së Financës, fishat e projekteve të reja të investimit, dhe relacione shpjeguese për domosdoshmërinë e shtimit, apo pakësimit të tyre).

Vazhdimisht

4. Në Raportet e Monitorimit të të dy viteve 2015 dhe 2016, nuk sqarohet domosdoshmëria e ndryshimit të aprovimit të buxhetit nga projekt buxheti, e aq më shumë domosdoshmëria e ndryshimeve në këto përmasa të projekteve të investimeve gjatë vitit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenit 65 “Monitorimi” në të cilin citohet: “Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm” (*Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni, grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtoria e Financës, në zbatim të ligjit të Menaxhimit Financiar, të justifikojnë performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt shumat e ndryshimeve të produkteve buxheteve gjatë vitit me dokumentacion justifikues (kërkesën e institucionit, miratimin nga grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtorisë së Financës fishat e projekteve të reja të investimit, dhe relacione shpjeguese për domosdoshmërinë e shtimit, apo pakësimit të tyre).

Vazhdimisht

5. Janë programuar shpenzime për investime në projekte të cilat janë projekte apo shpenzime korente si: Trajnime për biznesin, publikim në revista ekonomike ndërkombëtare, Trajnime për sistemin e sigurisë në plazhe, apo shpenzime për panaire të ndryshme etj, duke rritur kështu në mënyrë artificiale shpenzimet për investime, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku përcaktohen qartë: Menaxhimi i aktiveve është një pjesë themelore e menaxhimit financiar, prandaj është një prej përgjegjësive të Nëpunësit Autorizues në njësitë e sektorit publik. Kategori kryesore të aktiveve afatgjata të sektorit publik janë: Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara: Toka, ndërtesat, aktivet të trupëzuara të dhëna me lizing, magazinat dhe dyqane, fabrikat dhe makineritë, pajisjet, automjetet, mobilie dhe montimet, aktivet në ndërtim, aktivet fizike të dhuruara, aktivet e infrastrukturës, aktivet të trashëguara, punimet e artit dhe antikuaritet, soft-ware që zhvillohet nga vetë njësia. Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuara dhe Financiare: E drejta e autorit, markat, franchises, patentat, të drejtat e pronësisë intelektuale, emri i mirë, të dhënat dhe informacioni, njohuritë dhe know-how, licencat e përdorimit të soft-ware-ve, aksionet dhe obligacionet, kapitali i dividendit publik, huatë dhe depozitat dhe investime të tjera”. Në asnjë nga këto kategori nuk hyjnë “projektet” e mësipërme (*Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni, grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë dhe miratojnë shpenzimet buxhetore për projektet e investimeve kapitale, në përputhje me ligjin e menaxhimit financiar.

Vazhdimisht

6. Nga auditimi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave në këtë institucion rezultoi, se:

a. Për vitin 2015, shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit, sipas raporteve të monitorimit, janë më pak se sa vlera si rezultat i situacioneve të të ardhurave të çdo institucioni varësie për 5,311 mijë lekë, e cila përbëhet:

- Aparati i MZHETTS, për shumën prej 5,099 mijë lekë, me shkresën nr.1336, datë 16.02.2016 të Drejtorisë së Financës, dërguar Degës së Thesarit Tiranë “Mbi të ardhurat e pa përdorura të vitit 2015”, kërkojnë që nga të ardhurat e pa përdorura nga “ritja e autorizuar”, klasa 7, për këtë vit, në vlerë 5,099 mijë lekë, nga të cilat 607 mijë lekë, duhet të mbarten për vitin 2016, sepse përfaqësojnë vlerën e projektit “IADSA”, ku lider është Bashkia Çorovodë, ndërsa ministria është partner. Pjesa tjetër e të ardhurave të pa përdorura nga Aparati i MZHETTS, në shumën 4,491 mijë lekë, të kalojë derdhje në buxhet, shumë e cila nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, por është trashëguar për vitin 2016 në aparatën e këtij institucioni.

-Drejtoria e Përgjithshme e Marka Patentave, në vlerë 217 mijë lekë, shumë e cila nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, por është trashëguar për vitin 2016 në këtë institucion.

b. Edhe për vitin 2016, shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit, sipas raporteve të monitorimit, janë më pak se sa vlera nga situacionet e të ardhurave të çdo institucioni varësie, në vlerë 1,701 mijë lekë, shuma që nuk janë derdhur në buxhetin e shtetit, por janë trashëguar për vitin 2017 në këto institucione, diferencë kryesisht tek përdorimi i të ardhurave në:

-Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, në vlerë 1,275 mijë lekë;

-Aparatin e MZHETTS, në vlerë 225 mijë lekë;

-Drejtorinë e Përgjithshme e Markave dhe Patentave, në vlerë 201 mijë lekë. Për vitin 2016, nuk ka shkresa nga këto institucione për Degën e Thesarit Tiranë, për të kërkuar derdhjen e këtyre shumave të mbetura të pa përdorura, ashtu siç janë parashikuar në VKM dhe

udhëzimet e përdorimit të të ardhurave për çdo institucion buxhetor (*Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës, të urdhërojë me shkrim institucionet e varësisë që për diferencën e pa përdorur nga të ardhurat jashtë limitit, në vlerë 6,409 mijë lekë (4,708 mijë lekë për llogari të vitit 2015 dhe 1,701 mijë lekë për llogari të vitit 2016) të derdhen në buxhetin e shtetit nga institucionet:

-Aparati i MZHETTS për 4,716 mijë lekë (4,491 mijë lekë për llogari të vitit 2015 dhe 225 mijë lekë për llogari të vitit 2016);

- Drejtoria e Përgjithshme e Marka dhe Patentave, në vlerë 418 mijë lekë (217 mijë lekë për llogari të vitit 2015 dhe 201 mijë lekë për llogari të vitit 2016);

-Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, në vlerë 1,275 mijë lekë (për llogari të vitit 2016).

Menjëherë

7. Në aparatin e MZHETTS, për vitet 2015-2016 kontabiliteti dhe pasqyrat financiare janë organizuar dhe funksionojnë në përputhje me ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, pra regjistrimi në kontabilitet i veprimeve të lëvizjes së aseteve, aktiveve qarkulluese dhe cash-it mbahet me formatin e ditarëve dhe librave të kontabilitetit në exel, megjithëse programi “financa 5” është blerë nga ky institucion, por akoma nuk është vënë në funksion të plotë për shkak të ndryshimit të vazhdueshëm të specialistëve që e përdorin atë (*Trajtuar më hollësisht në pikën II të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës/Spektori i Financës të bëjë të mundur aplikimin e këtij investimi, duke rritur performancën e punës së këtij sektori, në shërbim të mirë administrimit të fondeve buxhetore.

Menjëherë

8. Për të dy vitet 2015 dhe 2016, është kryer inventarizimi i aktiveve të qëndrueshme dhe atyre qarkulluese, sipas udhëzimeve në fuqi. Ka filluar procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit, në maj të vitit 2016, është përgatitur dhe materiali për titullarin për të gjitha materialet për jashtë përdorimit, por nuk ka përfunduar kjo procedurë akoma, sepse materiali nuk ka dalë për zbatim nga titullari i institucionit (*Trajtuar më hollësisht në pikën II të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Struktura drejtuese të këtij institucioni dhe Drejtoria e Financës, të përcaktojnë në bazë të legjislacionit në fuqi afatet, komisionet për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe komisionet e asgjësimit, apo tjetërsimit të tyre, të përcaktuara të tilla në listat e inventarëve të aseteve për vitet 2015 dhe 2016.

Vazhdimisht

9. Nga auditimi i evidentimit dhe kontabilizimit në ditarin bankës dhe ditarin e shpenzimeve, rezultoi:

-Në likuidimet e vitit 2016 të fondit të investimeve për projektet e turizmit, dokumentacioni justifikues sipas marrëveshjes, VKM dhe kontratave, mbaheshin në dosje tek Drejtoria e

Turizmit, dhe jo të bashkëlidhura tek urdhër shpenzimet. Gjatë kohës së auditimit u bashkëlidhën për çdo urdhër shpenzimi dokumentacioni ligjor për likuidimin e këtij fondi.

-Në regjistrimet e urdhër shpenzimeve në ditarin e bankës në të dy vitet kishte përsëritje të konsiderueshme të numrave të urdhër shpenzimeve, numra të vitit për urdhër shpenzime të vitit të kaluar, apo data urdhër shpenzimesh, të cilat nuk korrespondojnë me radhën kronologjike të numrave serialë të tyre, duke e justifikuar këtë veprim me kthimet e shumta nga dega e thesarit dhe nga ndryshimet e shpeshta të specialistëve të financës (*Trajtuar më hollësisht në pikën II të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës/ Sektori i Financës, të përmirësojë regjistrimin kronologjik në kontabilitet, duke eliminuar veprime dhe regjistrime që krijojnë precedentë për pavërtetësinë e veprimeve kontabël, apo duke harxhuar kohë të pa nevojshme për rakordimin e regjistrimeve kontabël.

Menjëherë e vazhdimisht

10. Nga auditimi i plotësimit të pasqyrave financiare për vitin 2015 nga Aparati i MZHETTS, rezultoi se janë përpiluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, bilanci është përfunduar dhe dërguar në degën e thesarit në afat. Por nga auditimi i gjendjes së debi-kredive rezultoi se, ky institucion ka debitorë pa shpresa arkëtimi të krijuar para 15-20 vjetësh, të cilët kërkojnë një ndjekje dhe një analizë të mëtejshme për të qartësuar pozicionet e këtyre llogarive edhe me Ministrinë e Financave (*Trajtuar më hollësisht në pikën II të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Sektori i Financës, për pjesën e llogarive debitore që kalojnë kohën e parashkrimit, të hartojë një raport analitik për strukturat drejtuese të institucionit, duke përshkruar përpjekjet e institucionit për arkëtimin e tyre, për t'ju drejtuar Ministrisë së Financës për mënyrën e sistemimit të këtyre shumave që rrinë në llogaritë e saj për periudha edhe mbi 20 vjeçare. Për pjesën e llogarive kreditore, të cilat nuk u futën në strategjinë e detyrimit e prapambetura, të jenë pjesë e kësaj analize dhe raporti, për tu sistemuar.

Menjëherë

11. Nga auditimi i përmbledhëses e pasqyrave financiare për vitin 2015 rezultoi, se është e përpiluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës me 11 njësi buxhetore dhe është dërguar në Ministrinë e Financave në afat. Ndërsa për vitin 2016, kanë dorëzuar brenda afatit ligjor pasqyrat financiare të vitit 2016 në MZHETTS/Drejtorinë e Financës, vetëm 5 institucione varësie, nga 12 gjithsej duke bërë kështu të vështirë verifikimin dhe kontrollin e tyre, por edhe përpilimin e përmbledhëses së llogarive vjetore të institucionit në kohën e përcaktuar ligjërisht në Ministrinë e Financave. Nuk u konstatua komunikim zyrtar nga Drejtoria e Financës me institucionet e varësisë, si për afatin e shkelur dhe rregullimet e domosdoshme për pasqyrat financiare të vitit 2016 (*Trajtuar më hollësisht në pikën II të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës, të marrë masa paraprake me shkrim për të udhëzuar njësitë e varësisë për domosdoshmërinë ligjore të përpilimit, aprovimin dhe dorëzimin në kohë dhe me të gjitha

kërkesat ligjore, pasqyrat financiare nga njësitet e varësisë, duke përcaktuar dhe penalitete për mosplotësimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

12. Nga auditimi u konstatua se, referuar të dhënave mbi strukturat organike të MZHETTS, rezultoi një numër i konsiderueshëm vendesh vakante, ose 29 të tillë, nga të cilët 3 Drejtorë të Përgjithshëm, 4 Drejtorë Drejtorie, 5 Përgjegjës Sektori dhe 17 specialistë, si dhe qarkullime të stafit, fenomen i cili konstatohet për të dy vitet objekt auditimi, viti 2015 dhe 2016. Për pasojë, performanca e disa drejtorive me mungesë të vazhdueshme stafi, drejtues dhe specialistë, si dhe qarkullime të shpeshta të stafit, rrisin mos kryerjen me efikasitet të funksioneve të këtyre sektorëve në vetvete dhe dobëson performancën e institucionit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me DAP duhet të marrin masa të menjëhershme, që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit, duke shpallur dhe rishpallur nevojën për plotësimin e këtyre vendeve nëpërmjet thirrjeve të vazhdueshme, me qëllim plotësimin e strukturës dhe arrijtjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

13. Nga auditimi konstatohet se punonjës të MZHETTS kanë qenë pjesë e veprimtarisë së Këshillave Mbikqyrës në 36 shoqëri tregtare të formës sh.a, miratuar rast pas rasti nga titullari i MZHETTS, veprimtari e cila është shpërblyer sipas dispozitave ligjore. Po kështu, konstatohet se po me miratim të titullarit janë caktuar punonjës të aparatit të ministrisë si pjesë e bordeve të institucioneve të varësisë, ku dhe kanë marrë shpërblimin për pjesëmarrje. Të ardhurat e përfituara nga këto veprimtari dytësore nuk bashkohen me pagat e vendit të punës dhe më pas ti nënshtrohen tatimit dhe ndalesës për sigurimet shoqërore, por janë paguar në institucionin apo shoqërinë përkatëse. Kjo ka bërë që mbi këto të ardhura të aplikohet tatimi në burim prej 15% dhe jo tatimi i përshkallëzuar sipas nivelit të pagës. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ti kërkojë njësive të varësisë dhe shoqërive publike për nëpunësit e aparatit të ministrisë të caktuar në këshilla mbikqyrëse apo borde pagesa të kryhet në llogarinë e MZHETTS dhe tatimi të jetë sipas nivelit të përcaktuar për këtë rast.

Menjëherë

14. Nga ana e Titullarit të Autoriteti Kontraktor të MZHETTS-it, janë përfshirë në Njësitë e Prokurimit dhe në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, burime njerëzore të pakualifikuara dhe të pa trajnuara pranë APP-së, ndonëse, ekziston në strukturën e institucionit të MZHETTS-it, ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr.28 datë 27.02.2015, i ndryshuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 43, datë 26.03.2015, Sektori Prokurimeve, i cili nuk është i plotësuar plotësisht me burime njerëzore, si dhe del i aktivizuar në të shumtën e rasteve në realizimin e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël.

a. Në procedurën me objekt: *“Projekti Studimor Mice (Sfidat e Zhvillimit Ekonomik dhe Tregtar të Shqipërisë”* me fond limit 7,993,833 lekë pa tvsh, financuar nga Buxheti i Shtetit, me procedurë “Kërkesë për propozim”, realizuar në vitin 2016, nga auditimi rezultoi se:

-Njësia e Prokurimit i ka propozuar, Titullarit të AK-së, realizimin e procedurës prokuruese, duke gërshetuar tre elementë shërbimi (konsulencë, shërbim event, bërje spoti) në një procedurë të vetme, duke përzgjedhur procedurë të gabuar. Në pjesën më të madhe të këtij tenderi (sipas preventivit në DT) e zë studimi me karakter akademik-shkencor me 50% të vlerës së fondit limit, gjë që ngarkon me përgjegjësi NjP.

- Nga ana e KVO-së, në përfundim të procedurave të prokurimit është kualifikuar, operatori ekonomik "M.A", me ofertë me të ulur të paraqitur, megjithatë, nuk ka plotësuar Kriterin e veçantë të kualifikimit "Kapacitetin teknik" të parashikuar në pikën 2.3 të Shtojcës 6 të DST, për të cilën KVO-ja, ka skualifikuar operatorin tjetër ekonomik "D.P", gjë që ngarkon me përgjegjësi KVO-në.

-Komisioni i monitorimit, i ngritur për këtë prokurim, nuk ka përshkruar në ndonjë dokument se cilat janë detajet e spoteve të diskutuara me operatorin fitues, duke mos bërë transparent ecurinë dhe qëllimin e krijimit të tyre, në kundërshtim me Kontratën nr.7081/8, datë 04.10.2016, dhe me DT, Shtojca 8, pika 1.6 (d) thuhet se "3 spote promovuese, 3 minuta secili, për t'u prezantuar përpara çdo seance. Tematika dhe detajet e spotit do të diskutohen paraprakisht në MZHETTS". Nga auditimi rezultoi se, 3 spotet e kërkuara dhe të dorëzuara, nuk janë në minutazhin e përcaktuar në kontratë dhe DTS, por me një kohë më të shkurtër rreth 90 (sekonda) secili. Ky shërbim është paguar me vlerë prej: 2,378,400 lekë me tvsh, në kundërshtim me kontratën nr.7081/8, datë 04.10.2016, ligjin e Prokurimit Publik dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", duke mos pasur dokumentacionin dhe minutat e kërkuara për këtë shërbim, duke sjellë një efekt ekonomik negativ që ngarkon me përgjegjësi komisionin e monitorimit.

b.Nga auditimi në procedurën prokuruese me objekt: "Marrëveshja kuadër" me objekt "Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar dhe akomodim në hotele jashtë vendit" me fond limit me vlerë prej 7,500,000 lekë pa TVSH, financuar nga Buxheti i Shtetit, për vitin 2016, rezultoi se:

-Përllogaritja e fondit limit e hartuar nga grupi i punës, është më e lartë gati 30%, me vlerën e deklaruar në regjistrin e parashikimeve në APP, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.1, datë 15.01.2015, pika 32. Ky fakt tregon, moskoordinimin e strukturave të institucionit, që janë përfshirë në hartimin e rregjistrit të parashikimeve duke mos planifikuar vlerën e përafërt të fondeve publike për këtë shërbim.

- Njësia e prokurimit, nuk ka vendosur kritere të sakta, të cilat kanë sjellë vonesa të procedurës, në kundërshtim, me VKM-në nr.914, datë 29.12.2014, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", si pasojë dhe e faktit se, nga AK-ja, në përzgjedhjen e punonjësve në NjP, janë përfshirë burime njëzëre të pakualifikuara dhe të pa trajnuara pranë APP-së.

- Në bazë të Kontratës Marrëveshje Kuadër nr. 653/11, datë 05.04.2016, neni 5 (Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër) është përcaktuar deri në datën 31.12.2016, por realisht kjo Marrëveshje Kuadër, është konsumuar deri me datë 16.09.2016, (me 21 Minikontrata) me kohëzgjatje vetëm për 5 muaj të vitit buxhetor 2016.

-Nga auditimi i procedurave të minikontratave të lidhura në zbatim të MK, për dokumentacionin e mbajtur nga AK, është evidentuar se, për aktivitetet ndërkombëtare ekonomike, ku është e rëndësishme pjesëmarrja e institucionit të MZHETTS, në disa prej tyre nuk figuron Ftesa e organizatorëve, por është e reduktuar vetëm me MEMO e hartuar sipas rastit nga Drejtoria e Bashkëpunimit Ekonomik ose nga kabineti i Titullarit të AK. Gjithashtu, edhe në rastet kur janë të pasqyruara ftesat, (MEMOT) janë hartuar në ditët e afrimit të aktivitetit, e për pasojë, blerja e këtij shërbimi nëpërmjet kësaj procedure nuk e ka arritur qëllimin ekonomik, pasi, ka rezultuar, se çmimet e blerjes së biletave dhe akomodimi në hotele, janë të larta, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

-Njësia e Prokurimit, pranë MZHETTS-it ,të marrë të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartohen në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit, që kërkohet të prokurohet, të vendosen kritere të nevojshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të jenë të detajuara dhe të kuptueshme edhe nga bizneset e vogla, në përputhje me rregullat e prokurimit publik duke kërkuar shoqërimin me dokumente vërtetues , ku të përcaktohen dhe organet përkatëse, që lëshojnë këto dokumenta.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pranë MZHETTS-it, të marrë të gjitha masat, që operatorët ekonomikë, të cilët shpallen fitues, detyrimisht duhet të, plotësojnë kërkesat kualifikuese të miratuara, kjo në zbatim të rregullave të prokurimit publik.

- Nga ana e strukturave drejtuese të MZHETTS-it, të merren masa që shërbimet për aktivitetet ndërkombëtare të nisura mbi bazë të ftesash zyrtare, të planifikohen në një kohë sa më të shpejtë, në mënyrë që, procedurat e prokurimit për këtë qëllim, të realizohen në kohë duke dhënë efekt financiar ekonomik, në drejtim të uljes së vlerës monetare të blerjes së këtij shërbimi.

Vazhdimësisht

15.Në procedurat tenderuese që i përkasin sistemit të IT-së, për vitin 2016, nga auditimi i vlerës së përlllogaritjes së fondit limit, krahasuar me vlerën e realizimit të kontratave, është konstatuar, se vlera e fondit limit është gati 40% më e lartë se vlerat ofertuese fituese të paraqitura nga operatorët ekonomikë, duke treguar për mos seriozitet në paraqitjen e ofertave nga operatorë ekonomik të ndryshëm, me qëllim llogaritjen e fondit limit, konkretisht kjo paraqitet në procedurat me objekte:

“Sistemi informatikë për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave mbi Zonat e Lira Ekonomike, praktikat në lidhje me to, menaxhimi i burimeve dhe veçorive, data base e zonave të lira, operatorët e zonave, të dhënat financiare” (procedurë e hapur) vlera e përlllogaritur e kontratës 20,833,333 lekë pa tvsh, me fitues me vlerë oferte prej 12,607,000 lekë pa TVSH; *“Zhvillimi i Sistemit RDHSAT- Regjistri i të Dhënave nga Sipërmarrjet Akomoduese Turistike”* me procedurë “Kërkesë me propozim” me fond limit 7,952,000 lekë pa tvsh, me fitues me vlerë oferte 4,780,000 lekë pa tvsh.

-Autoriteti Kontraktor i MZHETTS-it, për të dyja procedurat tenderuese të mësipërme, i është drejtuar, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), duke marrë miratimin e projektit, por deri në këtë moment, nuk është realizuar plotësisht lidhja me portat hyrëse, me strukturat e tjera shtetërore, përgjegjësi kjo e AKSHI-it, konkretisht me ZRRPP (nuk funksionon) për administrimin dhe menaxhimin e pronave publike, dhe ISSH (nuk funksionon) për regjistrin e sipërmarrjeve akomoduese turistike. Ky veprim, ka bërë të mos jetë plotësisht funksional, në realizimin e qëllimit mbi të cilin u prokurua, duke venë në pikëpyetje efektivitetin, eficientën dhe ekonomikitetin e tyre. Këto programe të ndërtuara nga operatorët fituese, tashmë shërbejnë vetëm për stafin e drejtorive respektive të MZHETTS (pronës publike dhe turizmit) dhe jo për shoqëritë e bizneseve të interesuara shqiptare ose të huaja, në lidhje me këto fusha (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS-it, të ndiqen të gjitha rrugët procedurale administrative dhe ligjore, për t'i kërkuar institucionit të AKSHIT-it, realizimin e përgjegjësive të tij, në lidhje me implementimin plotësisht të sistemeve të IT-së.

Menjëherë

Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Turizmit (AKT) dhe në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve ose Albania Investment Development Agency (AIDA).

16. Nga auditimi, sipas Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 1191/3 prot. datë 21.02.2017, rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), si Autoritet Kontraktor, ka realizuar 3 (tre) procedura prokuruese, gjatë vitit buxhetor 2016, për prodhim dhe promovim të turizmit shqiptar në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, në kuadër të zhvillimit të projektit të zbatimit të brandimit të “Albania go your own way”, sipas aktit ligjor VKM nr.1195. datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve e të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruara, dhe në kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

-Mbi auditimin në lidhje me zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, “Mbi përgatitjen e një spoti promocional me rastin e kampionatit EUROPIAN Francë 2016” me fond limit 1, 683,333 lekë pa TVSH, e realizuar në qershor të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT), rezultoi:

-Kjo procedurë është iniciuar, nga Titullari i MZHETTS , me objekt mbi promovimin e turizmit në Euro 2016, në Francë. Mbi bazën e konfirmimit të porosisë të datës 07.03.2016, e firmosur nga zj.Ministre me përfaqësuesin e A.M.G, për të cilën në MZHETTS nuk ka dokumentacion shpjegues për këtë kontratë paraprake, e cila do të transmentonte spotin duke u paguar me vlerën prej 90 mijë Euro, nga buxheti i shtetit.

-Titullari i AKT-së, me Urdhër nr.278 prot. datë 03.06.2016 ka përcaktuar “Ngritjen e komisionit” i cili do të përcaktojë specifikimet teknike dhe studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit si dhe ka përcaktuar specifikimet teknike, duke e paraqitur sipas kostove të shërbimit që përbëjnë spotin prej 10” (sekonda) .

-Titullari i AKT-së, ka nxjerrë Urdhërin nr.79. datë 06.06.2016, “Për fillim procedure për prodhimin e 1 spoti promocional “Shqipëria në Euro 2016”. Në këtë urdhër është ngritur dhe komisioni për hartimin e dokumentave dhe ndjekjen e procedurave. Komisioni, po në datë 06.06.2016, ka hartuar, miratuar dhe dërguar Ftesë për Negociata tre kompanive (M.M; P.V dhe S.A) si dhe është hedhur në faqen e internetit të institucionit të AKT. Këto ftesa zyrtare nuk mbajnë konfirmimin nga operatorët ekonomik përkatës për vënien në dijeni të procedurës (orën dhe datën), në një kohë kur kërkohej paraqitja e ofertës dhe dokumentacionit, pa kaluar 24 orë.!, gjë që të shtyn të mendosh që këto kërkesa janë formale dhe të pamunduara të realizohen për kohën e vendosur në dispozicion nga AKT-ja.

-Procedura ka vazhduar në datën 07.06.2016, ku në orën 10:30 janë paraqitur të interesuar dy kompani, të cilat nuk bëjnë pjesë tek operatorët, që komisioni iu kishte dërguar Ftesat për negociim. Ofertat janë paraqitur në protokollin e AKT-së, nga subjektet si më poshtë:

1.R.T.A nr.278/9 prot me ofertë prej 1,510,000 lekë pa TVSH, e cila nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar, e për rrjedhojë është skualifikuar.

2.P.a nr.278/10 prot me ofertë prej 1,470,000 lekë pa TVSH, e cila ka plotësuar dokumentacionin dhe është shpallur fituese nga komisioni i vlerësimit.

-Autoriteti Kontraktor i AKT-së, ka dërguar shkresën nr. 278/12 prot. datë 07.06.2016, me objekt njoftimin e klasifikimit si dhe hartuar dhe miratuar Raportin përmbledhës mbi procedurën për realizimin e 1 spoti promocional “Shqipëria në Euro 2016”.

-Nga AKT-ja, është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 278/15 prot. datë 09.06.2016 me vlerë kontrate prej 1,764,000 lekë me TVSH, me kompaninë fituese “P.a” shpk.

–Nga Titullari i AKT-së, me Urdhër nr. 105. datë 09.06.2016 “Për ngritje komisioni të marrjes në dorëzim”, i cili e ka marrë në dorëzim, prodhimin e spotit në bazë të proces-verbalit të datës 13.06.2016 . Operatori fitues është paguar në bazë të Urdhër shpenzimit nr. 99. datë 17.08.2016.

-Nga auditimi konstatohet se, në bazë të “Konfirmim porosisë” së datë 07.03.2016, ky spot do të fillonte transmetimin prej datës 10 qershor deri në 10 korrik 2016, përgjatë eventit të Kampionatit European 2016, *ndërkohë spoti ishte gati më datë 13.06.2016*, pra tre ditë më vonë nga sa ishte parashikuar për transmetim. Pra, qëllimi mbi të cilin u procedua me një shpejtësi kohore, për të “prodhuar këtë spot” nuk u finalizua dot, si në kohë ashtu dhe në negociimin, duke e humbur objektin për të cilën u mendua që të reklamohej në këtë eveniment.

-Konstatohet se, ky spot nuk mundi të paraqitej për publikim, në ekranet e shpërndarë në territorin e shtetit të Francës, ku po zhvillohej Kampionati European i Futbollit 2016, me arsyetimin e shprehur në shkresën nr.2 78/15 prot, datë 22.06.2016, nga Titullari i AKT-së drejtuar Titullarit të MZHETTS-it, ku citohet se *“Gjatë korrespondencës me personin e kontaktit të A.M.G, AKT kërkoi vazhdimisht korrigjimin e datave dhe njëkohësisht dërgimin e faturës origjinale me firmë dhe vulë të njomë, pasi tashmë spoti ishte realizuar dhe pritej vetëm firmosja e kontratës së rregullt sipas datave të porosisë, për fillimin e procedurave. Në fillim të kërkesave tona, nga ana e A.M.G, u njoftuam se është bërë një gabim fillestar prej tyre dhe se periudha e transmetimit do të ishte nga data 27.06.2016 deri më datë 10.07.2016, pra 17 ditë më e shkurtër nga letra e konfirmimit të porosisë dhe se kjo ishte data e saktë për ta dhe nuk mund të ndryshohej. Vlen të theksohet se AKT ka kërkuar me insistim transmetimin e spotit gjatë datave që figurojnë në letrën e porosisë, mirëpo kërkesa në asnjë moment nuk u mor parasysh nga A.M.G. Gjithashtu AKT, kërkoi edhe një reduktim të kostos për transmetimin e spotit sipas datave 27.06.2016 -10.07.2016, të dërguara prej tyre për të cilën do të kërkohej miratim nga Ministria, mirëpo edhe për këtë kërkesë nuk u mor një përgjigje. “Në këto kushte, duke qënë se Agjencia Kombëtare e Turizmit realizoi në kohë spotin prej 10 (sekondash) sipas autorizimit të datës 03.06.2016 në kuadër të promovimit të turizmit Shqiptar në Euro 2016 me fondet e projektit Go Your Own Way, kërkojmë udhëzimet nga ana Juaj për vijimin e procedurave të mëtejshme me shoqërinë A.M.G, pasi shkresa e dërguar nga Ju, autorizon AKT-në vetëm për realizimin e spotit dhe kryerjen e pagesës së transmetimit të tij nga data 10.06.2016- 10.07.2016”.*

Përgjigja e Titullarit të MZHETTS-it , ishte negative sipas emailit të datës 24.06.2016, duke mos e realizuar qëllimin për të cilin u prodhua spoti për 10’, spot i cili sipas auditimit rezulton se është përdorur në promovion gjatë Festivalit të Venecias dhe jo gjatë kampionatit Evropian.

Ecuria e marketingut të këtij spoti ka vazhduar në datë 25.08.2016, ku AKT-ja, i është drejtuar përsëri Ministrit të MZHETTS, ku është kërkuar aprovimi për transmetimin e spotit promovues të Shqipërisë prej 10 (sekondash) i cili tashmë, duhej të shfaqej në Festivalin e Venecias 2016.

- MZHETTS-si me shkresën nr. 7099/1 prot, datë 30.08.2016, ka miratuar kërkesën e mësipërme.

Gjatë auditimit, konstatohet se:

-Ekziston komunikimi elektronik, me kompaninë O.R me seli në Londër (Angli), me AKT përfaqësuar nga ish-drejtori i Marketingut në AKT, ku është pranuar “Silver package”12x30” spote në ditë për 11 ditë. Në këtë ofertë *del e paqartë*, që është spoti prej 10’(sekonda) i cili u prodhua nga kompania fituese “P.a” si më sipër, për tu publikuar në “Euro 2016” apo kemi të bëjmë me ndonjë spot tjetër ? Në faturën e sjellë nga kompania e huaj “R.E” London, flitet për spot 30’(sekonda).

- Nga auditimi i dosjes fizike, Kompania e cila ka ekskluzivitetin për trasmetimin e spotit është *“OR” me këto të dhëna ([REDACTED])* dhe nuk jepet asnjë dokumentacionin ligjor, asnjë argumentim faktesh, për lidhjen që kanë këto kompani “të përzgjedhura nga AKT”?

-Është realizuar pagesa me Urdhër-Shpenzimi nr. 153, datë 14.10.2016, në mbështetje të Urdhër “Për kryerje pagesë” nr.147, datë 10.10.2016, me shkresë nr. 508 prot datë 10.10.2016 nga Drejtori i Përgjithshëm AKT-së, përfituesi del “R.E, Londër”.

-Monitorimi i promovimit të spotit, i është besuar tërësisht kompanisë “R.E” London, ku del përsëri e paqartë për kohëzgjatjen e spotit nëse është 10 sekonda apo 30 sekonda.

Pra, si konkluzion, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrës (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë, prodhimin dhe publikimin këtij spoti, duke mos dhënë alternativa të qarta mbi publikimin dhe përzgjedhjen e kompanive të huaja, për të promovuar vendin tonë si një destinacion turistik në arenën ndërkombëtare, përgjegjësi kjo e MZHETTS-it dhe AKT-së, duke mos patur gjurmë të plota dokumentare, që nga faza e nisjes së prodhimit të spotit (i cili do të reklamohej gjatë Kampionatit Evropian) ashtu dhe nga përzgjedhja e aktivitetit të Venecias, për promovimin final të këtij spoti dhe mungesë dokumentacioni të plotë për monitorimin e tij. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS-it si institucion qendror dhe nga AKT si njësi varësie, të merren të gjitha masat që prodhimet, publikimet dhe transmetimet e spoteve turistike, të planifikohen në kohë, të harmonizohen strukturat midis tyre, në përputhje me bazën ligjore, në mënyrë që për çdo hallkë të procedurës të kemi tablo të qartë, të transparencës, të nxitjes së konkurrencës, barazinë e operatorëve ekonomikë, për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Vazhdimisht

17. Mbi auditimin në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, “Për fushatën e Integruar e Marketingun për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way” me fond limit prej 51,800,000 lekë pa TVSH, realizuar në gusht të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT).

Nga auditimi u evidentua se, për të gjithë shërbimet e objektit, për procedurën e Fushatës së Integruar e Marketingut për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way”,

-Sipas shkresës nr. 6118 prot, datë 29.07.2016, janë përzgjedhur 2 këshilltarë nga kabineti i Ministrit të MZHETTS-it, në kundërshtim me Urdhrin nr. 5938, datë 22.07.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” Kreu II neni 6(Kabineti i Ministrit), e cila është strukturë ndihmëse, që shërben si organ këshillimor pranë Ministrit, duke ushtruar të gjitha funksionet e parashikuara në ligjin nr. 90/2012. Ndërkohë, në strukturën e MZHETTS, ekziston Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, prej nga, Titullari, mund të kishte përzgjedhur anëtarët e grupit të punës ose nga strukturë tjetër kompetente në MZHETTS.

- Komisioni i vlerësimit, duhet të vendoste, kritere teknike, të cilat duhet të garantonin cilësinë e kërkuar, duhet të vendoste kërkesa të veçanta për kualifikim, në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, me dokumenta konkrete që duhet të paraqisnin operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterëve (dokumentacion financiar dhe ekonomik, licenca, dëshmi profesionale, nënkontraktime më të tretë për të realizuar objektin, kapacitete të burimeve njerëzore, etj), e për pasojë, do ta bënte më transparente mënyrën e prodhimit, publikimit dhe transmetimit të spoteve turistike.

-Mos monitorimi nga AKT-ja, me burime njerëzore të kualifikuara apo me personel të strukturave të turizmit në MZHETTS, nuk ka dhënë tablonë e qartë, të mënyrës së nënkontraktimeve, që operatori fitues “R.TA” shpk, ka realizuar me operatorë vendas apo të huaj.

-Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës të AKT-së, ka dokumentuar aktivitetin bazuar *vetëm* në dokumentacionin e firmës kontraktuese dhe pjesërisht të operatorit M.C, duke treguar se nuk ka kapacitete të burimeve njerëzore që mund të monitorojnë , fondet publike të Buxhetit të Shtetit, bazuar në funksionin kryesor të AKT-së, promovimin e vendit tonë në fushën e turizmit.

Pra, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë për prodhimin, publikimin e transmetimin të spoteve turistike. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e Titullarit të MZHETTS, të përcaktohen në komisione burime njerëzore, për realizimin e procedurave të prokurimeve, kur kërkohen nga njësitë e varësisë, persona kompetente në përshtatje me detyrat funksionale të përcaktuara dhe (jo këshilltarë të kabinetit), në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore.

Nga AKT-ja të merren masa për realizimin e monitorimit sa më të saktë dhe dokumentimin në mënyrë që të jenë sa më të besueshëm publikimi i spoteve turistike, si brenda dhe jashtë vendit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

18. Mbi auditimin në lidhje me zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, *“Për fushatën e Integruar e Marketingun për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way”* e realizuar sipas VKM-së nr. 1195, datë 05.08.2008 me fond limit prej 9.600,000 lekë pa TVSH, realizuar në dhjetor të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT).

Nga auditimi rezulton se, për të gjithë shërbimet e objektit, për procedurën e Fushatës së Integruar e Marketingut për Promovimin e Turizmit *“Albania Go Your Own Way”*, nga auditimi u evidentua se:

- Komisioni i vlerësimit, duhet të vendoste, kritere teknike, të cilat duhet të garantonin cilësinë e kërkuar, duhet të vendoste kërkesa të veçanta për kualifikim, në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, me dokumenta konkrete që duhet të paraqisnin operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterëve (dokumentacion financiar dhe ekonomike, licenca, dëshmi profesionale, nënkontraktime më të tretë për të realizuar objektin, kapacitete të burimeve njerëzore, etj), e për pasojë, do ta bënte më transparent mënyrën e prodhimit, publikimit dhe transmetimit të spoteve turistike.

-Mos monitorimi nga AKT-ja, me burime njerëzore të kualifikuara apo me personel të strukturave të turizmit në MZHETTS, nuk ka dhënë tablonë e qartë, të mënyrës së nënkontraktimeve, që operatori fitues *“Publicita”* shpk, ka realizuar me operatorët ndërkombëtarë.

-Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës të AKT-së, ka dokumentuar aktivitetin bazuar *vetëm* në dokumentacionin e firmës kontraktuese dhe pjesërisht të operatorit M.C, duke treguar se nuk ka kapacitete të burimeve njerëzore që mund të monitorojnë, fondet publike të Buxhetit të Shtetit, bazuar në funksionin kryesor të AKT-së, promovimin e vendit tonë në fushën e turizmit.

Pra, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë për

prodhimin, publikimin e transmetimin të spoteve turistike. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS-it si institucion qendror dhe nga AKT si njësi varësie, të merren të gjitha masat që prodhimet, publikimet dhe transmetimet e spoteve turistike, të planifikohen në kohë, të harmonizohen strukturat midis tyre, në përputhje me bazën ligjore, në mënyrë që për çdo hallkë të procedurës të kemi tablo të qartë, të transparencës, të nxitjes së konkurrencës, barazinë e operatorëve ekonomikë, për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Menjëherë dhe vazhdimisht

19. Nga auditimi i realizuar, sipas Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 1191/4 prot datë 21.02.2017, pranë Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ose Albania Investment Development Agency (AIDA) si Autoritet Kontraktor, konstatohet se, është realizuar 1(një) procedurë me objekt: “*Botimi në median e shkruar ndërkombëtare të një artikulli për promovimin e Shqipërisë*” me fond limit prej 36,000,000 lekë me TVSH e siguruar nga Buxheti i Shtetit.

-Nga auditimi rezultoi se nga ana e komisionit është përgatitur ftesa për negociata, e cila është publikuar vetëm në **Web-in** e AIDA-s, dhe nuk është shpërndarë me korrespondencë zyrtare, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” pika II (Procedura për realizimin e një programi, të një reklame apo spoti) nënpika 9.

-Nga AKT-ja, në zbatim të nenit 23 të Statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe pikës 2 të kontratës nr. 3/5 datë 13.01.2016, është kryer pagesa e kompanisë “Q.C.P” ltd sipas faturës së datës 26.01.2016”, duke mos u shoqëruar me dokumentacionin përkatës për çdo element përbërës të procedurës. Nuk jepet asnjë informacion, mbi shpërndarjen e 5000 kopjeve të revistës “*The Economist*” në Davos, si dhe 1500 kopjeve në Shqipëri. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e AIDA-s, të merren të gjitha masat, duke analizuar mbi mënyrën e ecurisë së publikimeve, duke respektuar bazën ligjore, për çdo hallkë të procedurës dhe veçanërisht monitorimi i kontratës, për të pasur përdorim sa më efektiv, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe vazhdimisht

20. Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e procedurës për marrje me qira të pasurisë publike nga shoqëria “P” konstatohet se, për vitin 2015 kjo shoqëri nëpërmjet programit “Për nxitjen e punësimit”, ka përfituar financime buxhetore nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit për 91 punonjës. Fakt që tregon se, punësimi nuk ka ardhur si rrjedhojë e favorizimit nëpërmjet kontratës simbolike “1 Euro” por nëpërmjet fondeve publike të financuara nga “Shërbimi kombëtar i punësimit”. Për këtë, shoqëria “Albpetrol” që administron këtë pronë, së bashku me grupin e monitorimit, nuk kanë pasqyruar dhe llogaritur diferencën e mundshme midis vendeve të punës sipas kushteve të kontratës me vendet e punës të financuara nëpërmjet përfitimit nga fondet e “shërbimit kombëtar të punësimit”; dhe për çdo vend pune të pa çelur, shoqëria të penalizohet në masën 50,000 lekë

për çdo vend pune të pahapur”, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 7 “penalitetet” pika 7.2 e kontratës.

- Nga monitorimi i kontratave të qirave rezulton se dhe shoqëria “L” nivelin e punësimit e ka arritur nëpërmjet projekteve të nxitjes së punësimit, të përfituara nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, pa ndarë vendet e punës të çelura nga vetë shoqëria me ato të financuara nëpërmjet projekteve. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Pronës Publike pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, së bashku me Komisionet e Monitorimit të kontratave të hartojnë një program të përbashkët me “Shërbimin Kombëtar të Punësimit”, me qëllim evidentimin e të gjithë shoqërive qiramarrëse që kanë përfituar fonde publike për punësim dhe penalizimin e atyre sipërmarrësve që kanë krijuar vende të reja pune nëpërmjet fondeve publike, duke i raportuar vende pune të krijuara nga kontrata favorizuese “1 Euro”.

Menjëherë

21. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë prodhuese me “Fason” që kanë ndryshuar kushtet e kontratave të mëparshme, nga pagesa me qira mujore për metër/katror në kontrata favorizuese simbolike “1 Euro”, konstatohet se: Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë rreth 80 % të kostos së prodhimit, madje “M.T.C”, deklararon se, aktiviteti që zhvillon kjo shoqëri favorizohet së tepërmi nga kosto e ulët e fuqisë punëtore, e cila në Shqipëri varion nga 8 deri 12 herë më e ulët se në Austri dhe Gjermani (lënda e parë e porositesit nuk kontabilizohet në shpenzimet e prodhimit).

Në lidhje me këtë situatë të favorshme që gjejnë këto shoqëri, Drejtoria Pronës Publike në MZHETTS, në kërkesat për kualifikim dhe favorizimin e tyre nëpërmjet ndryshimit të kushteve të kontratës nga lekë/m² në kontrata simbolike “1 Euro”, nuk ka përcaktuar kritere dhe rregulla të veçanta për mbrojtjen e të punësuarve.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se, në asnjë rast nuk janë vendosur kushte për nivelin e pagave dhe depozitimin e formularit të pagesës së sigurimeve shoqërore model Esig-25, si për aktivitetin fillestar që kryen para zgjerimit të pronës ashtu edhe gjatë monitorimit të kontratës simbolike “1 Euro”, që krahas deklaramit të investimeve të kryera, të depozitojnë edhe formularin model “E sig 25” miratuar nga Degët e Tatim Taksat, për justifikimin e çeljes së vendeve të reja të punës me pagat referuese të Këshillit Ministrave, moshën e çdo të punësuar, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë të punësuar, si dhe mbrojtjen nga shfrytëzimi i fëmijëve të mitur nën 16 vjeç. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Pronës Publike në MZHETTS, në kërkesat për kualifikim në procedurat e dhënies me qira të pasurisë publike të përcaktojë kritere dhe rregulla të veçanta për mbrojtjen e të punësuarve. Pas lidhjes së kontratës, në një nen të veçantë të vendosen kushte për kontraktuesin që në marrëdhëniet e punësimit detyrimisht të vendoset si referencë paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Po kështu edhe gjatë fazave të monitorimit për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, pjesë e dokumenteve të monitorimit të jetë edhe formulari i sigurimeve shoqërore model Esig-25 miratuar nga Degët e Tatim Taksat, si dokument bazë për justifikimin e çeljes së vendeve të reja të punës.

Menjëherë

22. Nga auditimi konstatohet se njësitë monitoruese nuk paraqesin raportet për monitorimin e kontratave që ato administrojnë, ose raportet janë thjesht formale, të njëanshme dhe pa dokumentacionin e duhur justifikues. Nga MZHETTS, nuk janë vënë para përgjegjësish dhe nuk është marrë asnjë masë administrative ndaj njësive monitoruese që administrojnë pronën publike, të cilat janë mjaftuar me informacione periodike vetëm për pagesat mujore duke mosrealizuar monitorimin e nivelit të investimit apo të punësimit, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI “Monitorimi i kontratave”, pika 1, “*Monitorimi i kontratave të qirasë dhe enfiteozës bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, si dhe Degët e Shoqërive Publike në qarqe...*”

pika 2/c, “*Njësia monitoruese ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë dhe çdo 6 muaj, harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteoze marrëse...*”

pika 2/e, “*Njësia monitoruese, çdo 3 muaj, dërgon në organin që ka lidhur kontratën e qirasë ose enfiteozës, raportin përkatës për realizimin e derdhjes së detyrimeve të qirasë mujore dhe treguesve të tjerë të kontratës (realizimi i punësimit dhe investimit të marrë përsipër në kontratën e qirasë, shoqëruar me dokumentin e derdhjes dhe çdo dokument tjetër të vlefshëm...*”, kështu:

a. Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e monitorimit dhe kushteve të kontratës së lidhur shoqërinë “M.T.C”shpk, të përcaktuara në nenin 5, pika 5.5 dhe 5.6 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, konstatohet se:

Në përfundim të afatit 12 mujor në datën 29.07.2016 edhe pse kanë kaluar mbi 6 muaj nga dita e përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratë, përsëri deri në datën e sotme nuk është paraqitur raporti përfundimtar i monitorimit, nga administratori i “N.P.D”sh.a.

b. Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e monitorimit të kontratës së lidhur me shoqërinë “L”shpk, rezulton se, nga njësia monitorues Bashkia Bulqizë është raportuar se deri më 30.12.2015 ky subjekt nuk ka filluar akoma aktivitetin dhe se është në fazën e marrjeve të lejeve. Për ecurinë e mëvonshme të kësaj kontrate nga kjo njësi monitoruese nuk ka raportime të shoqëruara me akte monitorimi, edhe pse kishte mbi 6 muaj që ka përfunduar faza e parë e projektit, që është data 31.07.2016. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Pronës Publike së bashku me Njësitë e Monitorimit të kontratave të hartojnë një program të përbashkët që në çdo fazë të monitorimit të shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në kushtet e kontratës, si për kryerjen e investimeve dhe respektimin e punësimit për çdo fazë të përcaktuar në kontratat e lidhura midis palëve.

Menjëherë

23. Nga auditimi konstatohet se, nga përfaqësuesit e Degëve të Shoqërive Publike në 12 Prefektura, të cilat janë pjesë e strukturës së MZHETTS nuk ka informacion të saktë për sipërfaqen e përgjithshme të dhënë me qira nga të gjitha subjektet që veprojnë në Prefekturën përkatëse(sipërfaqe nën objekt apo funksionale), si dhe vlerën kontabile të kësaj pasurie, e për rrjedhojë ministria si përgjegjëse për ekonominë dhe përfaqësuese e pronarit shtet, nuk ka një regjistër mbarëkombëtar për pronat e dhëna me qira (nën 200m² dhe mbi 200m²) dhe as pronat e disponueshme për tu dhënë me qira në mënyrë që të bëhen transparente procedurat e konkurrencës dhe të ketë pjesëmarrje më të gjerë dhe jo si deri më tani, ku pothuajse të gjitha

procedurat janë zhvilluar vetëm me një konkurrent, duke mos përmbushur kërkesat e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI “Monitorimi i kontratave”, pika 3. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore, të marrë masa të menjëhershme për evidentimin e të gjitha pronave të dhëna me qira nga autoritetet kontraktore, pavarësisht nga varësia institucionale, si dhe vlerën e tyre kontabile, me qëllim hartimin e *një regjistri mbarëkombëtar për pronat e dhëna me qira.*

Menjëherë dhe Vazhdimisht

24. Nga auditimi për monitorimin e kontratave të qirasë që aktualisht monitorohen nga institucioni, për mos realizim të nivelit të investimeve dhe të punësimit sipas kushteve të përcaktuara në kontratat e lidhura midis palëve, janë llogaritur penalitete për 5 kontrata, gjithsej në shumën prej 17,158,066 lekë, e konkretisht:

-Për subjektin “L” Shpk, për kontratën e qirasë me objekt prodhim konfeksione, në objektin e Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit, Librazhd, konstatohet se nga dokumentacioni që administrohet në dosjen e subjektit, raporteve të monitorimit nga njësi monitoruese dhe nga raporti i ekspertit kontabël, bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2015, raportohet se, është arritur vlera e investimit, por ky investim nuk vërtetohet me asnjë dokument tjetër vërtetues si, situacione, fatura, etj.). Në raportin e ekspertit kontabël nuk del qartë investimi i kryer në këtë objekt, ku konstatohet se treguesi i punësimit nuk është plotësuar. Referuar vërtetimit të datës 01.11.2016 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Elbasan, kjo shoqëri ka punësuar mesatarisht për fazën e parë vetëm 3 punonjës, nga 70 vetë të parashikuar, pra me një diferencë për 67 vetë. Po sipas këtij vërtetimi ky subjekt ka të punësuar mesatarisht 58 vetë deri në muajin shtator 2016, ose me një diferencë për 92 punonjës.

Në nenin 7 të kontratës “Penalitetet” pika 7.2 , përcaktohet se: “Në rastin kur “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze për punësimin sipas plan biznesit nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.6 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50,000 lekë për çdo vend pune të pahapur”. Referuar këtij neni të kontratës, për fazën e parë të realizimit të nivelit të punësimit “Qiramarrësi” i llogaritet një penalitet në shumën 3.350,000 lekë (67 vetë x 50,000 lekë) ndërsa për fazën e dytë penaliteti është 4,600,000 lekë(92 vetë x 50,000 lekë), pra gjithsej në shumën 7,950,000 lekë.

-Për subjektin “S”, për kontratën e qirasë së truallit të objektit “Spitali Universitar “Nënë Tereza”, me objekt “Parkim mjetesh në territorin e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza”, për mosrealizim të nivelit të investimeve, penalizohet sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5.7 të kontratës së lidhur midis palëve në masën 10 % për çdo vit të vlerës së investimeve të pakryera, në vlerën prej 358,066 lekë. (1.970 mijë x 10% x 2 vjet).

- Nga monitorimi i kontratës së shoqërisë “P” Shpk në objektin e ish NPV Durrës, rezulton se, subjekti qiramarrës nuk ka plotësuar kushtet e kontratës, si për nivelin e investimit dhe punësimin, ku i llogaritet një penalitet prej 7,200,000 lekë.

-Për subjektin “L” Shpk, për kontratën e qirasë me objekt prodhim konfeksione, në objektin e Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit, Plasë, Korçë, konstatohet se nuk ka arritur nivelin e punësimit në fund të fazës së parë, e për rrjedhojë penalizohet me gjobë, në masën 50,000 lekë për çdo vend pune të pahapur, në shumën 400,000 lekë (8 vetë x 50,000 lekë).

-Për subjektin “L” Shpk, për kontratën e qirasë me objekt prodhim "pellet druri", në truallin në administrim të Bashkisë Bulqizë, rezulton se, në përfundim të çdo faze për punësimin sipas plan biznesit nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.6 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50,000 lekë për çdo vend pune të pahapur”. Referuar këtij neni të kontratës, për fazën e parë të realizimit të nivelit të punësimit, referuar vetëm raportimeve të bërë prej tij, “Qiramarrësit” do ti llogaritet një penaltet në shumën 1,250,000 lekë (25 vetë x 50,000 lekë). (Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Pronës Publike së bashku me Njësitë e Monitorimit të Kontratave të nisin procedurat ligjore për penalizimin e shoqërive mbështetur në nenin 7.2 të kontratave, për mos kryerje të investimeve dhe të nivelit të punësimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5.7 të kontratës së lidhur midis palëve, gjithsej në shumën prej **17,158,066 lekë, duke kërkuar dhe arkëtimin e kësaj shume nga këta subjekte.**

Menjëherë

25. Nga auditimi në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve(ATRAKO), *për zbatimin e ligjshmërisë në evidentimin e koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat*, konstatohet se, deri më tani nga Këshilli i Ministrave nuk është hartuar e miratuar një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësor për investime, të bazuara te partneriteti publik privat, të formave të preferuara të partneritetit publik privat dhe çështje të tjera që lidhen me kuadrin e përgjithshëm të politikave për koncesionet, kërkesë e nenit 8, pika 5 e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP”, i ndryshuar.

Gjithashtu, konstatohet se dhe ministria përgjegjëse për ekonominë (MZHETTS) nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut dhe propozime prej saj, edhe pse referuar nenit 9/1 të ligjit të koncesioneve/ppp përcaktohet si institucioni përgjegjës, i cili orienton dhe harmonizon veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/ppp.

Nga auditimi konstatohet se nga ATRAKO është hartuar regjistri i koncesioneve, duke përmbushur kështu kërkesën e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP”, nenit 14 “Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat”, por aktualisht në këtë regjistër janë hedhur vetëm 160 kontrata koncensionare, ndërkohë që janë shumë kontrata koncensionare të lidhura nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të cilat nuk janë përfshirë në këtë regjistër, edhe pse ka kaluar një vit nga hyrja në fuqi e VKM nr. 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesioneve dhe partneritetit publik privat”, ku ka lindur dhe detyrimi për të gjithë Autoriteteve Kontraktore (Ministrive të Linjës dhe Njësive të Qeverisjes Vendore), që të përcjellin pranë Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, kontratat e nënshkruara prej tyre, për tu publikuar në regjistrin elektronik. (Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

ATRAKO, si një hallkë e rëndësishme në procesin e koncesioneve/ppp, si institucioni që ka për mision nxitjen dhe asistimin e autoriteteve kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/ partneriteteve publike private, në bashkëpunim me MZHETTS dhe Këshillin e Ministrave të ndërmarrin hapat për të hartuar një strategji të mirëfilltë politikash dhe përcaktimin e sektorëve parësorë të zhvillimit të koncesioneve/ppp.

ATRAKO, të kërkojë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë(MEI) paraqitjen sa më të shpejtë të të gjitha kontratave koncensionare (në fushën energjetike, naftë apo minerare) për plotësimin e detyrimit të parashikuar në VKM nr. 211, datë 16.03.2016 dhe me qëllimin final

evidentimin në regjistër në mënyrë të saktë të të gjithë pasurisë shtetërore të dhënë me koncesion/ppp.

Menjëherë

26. Nga auditimi i mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për arkëtimin e tarifës koncensionare, konstatohet se, nga KLSH në auditimin e ushtruar në vitin 2013, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për koncesionet, për periudhën 01.10.2011 deri më 31.12.2012”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 8, datë 10.02.2014 dhe dërguar në subjekt me shkresën nr.478/25, datë 14.02.2014, është konstatuar se, për zbatimin e kushteve të Kontratave Koncensionare, nuk është punuar për rilllogaritjen e tarifës që Koncensionarët fitues paguajnë për Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve në zbatim të VKM nr.191, datë 22.03.2012, (ndryshim i VKM nr. 150, datë 22.03.2007), për arkëtimin e saj në buxhetin e shtetit. Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e vitit 2012, ka llogaritur mungesë të ardhurash në vlerën **1,113,730,319 lekë**, detyrim që duhet paguar nga Koncensionarët e shpallur fitues. Nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve është punuar për vjeljen e tarifës për periudhën nga dalja e VKM nr. 191, datë 22.03.2012 e vazhdim, por jo që nga data 22.03.2009, periudhë që ka shtrirë efektet vendimi. Me shkresën nr. 478/25, datë 14.02.2014, i është rekomanduar subjektit të audituar, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, të bëjë rilllogaritjen e vlerës tarifës, që koncensionarët duhet të paguajnë me ndryshimet e bëra me VKM nr.191, datë 22.03.2012, të bëjë kontabilizimin dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të vitit 2013 të detyrimeve për këtë tarifë (të analizuar sipas viteve 2012-2013), rekomandim i cili jo vetëm nuk është zbatuar nga ky institucion, por nuk i është përcjellë për veprime të mëtejshme ATRAKO-s, e për pasojë në kontabilitetin e Agjencisë nuk rezultojnë të regjistruara këto detyrime të mbartura të koncensionarëve ndaj saj.

Po kështu, nga auditimi i ushtruar nga KLSH në vitin 2015, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar dhe vendimmarrjes në marrëveshjet koncensionare”, të ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 140, datë 30.09.2015, është konstatuar moszbatimi i rekomandimit të mësipërm. Me shkresën nr.118/12, datë 12.10.2015 është rikërkuar nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë që të marri masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimit.

Përgjatë viteve 2012 dhe 2013, referuar akt rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë, janë arkëtuar tarifa koncensionare në shumën 63,766,686 lekë, pra mbeten detyrime të pa shlyera nga shoqëritë koncensionare në shumën 1,049,963,633 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

ATRAKO në bashkëpunim me MZHETTS, të kërkojë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, materialet e auditimit të ushtruar në këtë institucion për koncesionet, masat e marra nga ky institucion për zbatimin e rekomandimeve të lëna, me qëllim evidentimin në kontabilitetin e ATRAKO-s të detyrimeve të përllogaritura të koncensionarëve dhe arkëtimin e tyre.

Menjëherë

27.Nga auditimi për vlerësimin e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm u konstatua se nga kjo strukturë prej dy vitesh është hartuar Karta e Auditimit, kërkesë e ligjit dhe e manualit të auditimit të brendshëm, por akoma nuk është miratuar nga Titullari i institucionit. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm së bashku me menaxherët e lartët të institucionit të marrë masa të menjëhershme për miratimin e Kartës së Auditimit.

Menjëherë

28. Në planet vjetore të auditimit parashikohen fushat dhe subjektet me risk, si dhe periudha që do të auditohet, që në disa raste është 3 deri në katër vjet e pa audituar, por kjo periudhë nuk parashikohet e plotë, duke lënë jashtë auditimit periudha të afërta me kohën e ushtrimit të auditimit, duke humbur kështu koherencën e misionit, si dhe të gjetjeve e rekomandimeve.

Programet e auditimit janë hartuar në mënyrë formale, duke renditur çështjet që do të auditohen në mënyrë skematike për çdo auditim, pavarësisht natyrës dhe veprimtarisë së ndryshme që ka çdo subjekt që i nënshtrohet auditimit.

Koha e shpenzuar për çdo auditim është parashikuar e shkurtër nga 5 deri 10 ditë, pavarësisht se auditohet një periudhë rreth 3 deri 4 vjet. Në këto raste ndonëse subjektet e parashikuara nuk auditohen për një periudhë tepër të gjatë veprimtarie, në programet e punës programohet vetëm auditimi i gjysmës së periudhës, duke lënë pa audituar veprimtarinë e një periudhe nga 1 deri në 2 vjet para datës që miratohet programi i auditimit. Kjo mënyrë programimi nuk është efektive, pasi duke lënë pa audituar një veprimtari relativisht të gjatë jo vetëm sjell rritjen e kostos së auditimit por edhe mangësitë e konstatuara nuk zbulohen në kohë duke humbur aktualitetin në auditimin tjetër pasardhës. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla pune, të planifikohen dhe auditohen subjektet për të gjithë periudhën e pa audituar, hartimin e programeve sipas specifikave të institucioneve, si dhe përlllogaritja e kohës që do të shpenzohet për auditim, kjo konform kërkesave të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

Menjëherë

29. Në programet e punës, ndonëse i kushtohet në vëmendje e veçantë e auditimit të rekomandimeve të lëna në periudhat e mëparshme, konstatohet se këto rekomandime përgjithësisht nga disa subjekte nuk rezultojnë të jenë marrë masa konkrete për hartimin ne programeve të zbatimit të rekomandimeve. Kështu, në të gjitha Degët e Shoqërive Publike procesi i privatizimit ka një ecuri tepër të ngadaltë, që vinë si rrjedhojë e mosrespektimit të afateve për vlerësimin e pronës, mos hartimin e genplaneve në afat, deri tek vonesat e miratimit nga ana e institucionit të prefektit, duke sjellë si pasojë dëmtimin e objekteve dhe uljen e vlerës së privatizimit si rrjedhojë e zgjatjes së afatit të procedurave të privatizimit.

Rekomandimi për shpejtimin e procesit të privatizimit konsiderohet formal, pasi në të gjitha rastet e audituara, Grupi i Auditimit të KLSH-së konstaton se, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kthen përgjigje se, “...nuk disponon të dhëna të sakta për kërkesa pronësia apo pronarë të mundshëm, për pjesën e truallit nën ndërtesë apo sipërfaqen funksionale, pasi inventarizimi i pasurisë publike është në proces inventarizimi dhe dixhitalizimi”. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Çdo përshpejtim për privatizimin e pronës publike, pa evidentuar pronarët e mundshëm të trojeve do jetë pa efektivitet pasi do vendosë pronën publike përballë proceseve gjyqësore, duke krijuar shqetësime jo vetëm për qytetarët që kërkojnë rikthimin e pronës por edhe kosto e lartë për buxhetin e shtetit pasi do kërkojnë fonde për kompensimin e ish pronarëve me çmimet e tregut të cilat kanë tendencë të rriten nga viti në vit.

Vazhdimisht

30. Nga vlerësimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në këtë institucion rezulton se, nga kjo njësi është ushtruar auditim i plotë në Sh.a “K”, Vlorë. Nga ky auditim është konstatuar mungesë të dokumentacionit administrativ dhe financiar për veprimtarinë e ushtruar nga kjo shoqëri, si për shpenzimet ashtu dhe të ardhurat deri në vitin 2015. Në përfundim të auditimit, nga Titullari i ministrisë është kërkuar nga Nëpunësi i Parë Autorizues fillimi i inspektimit financiar, misioni i cili është kërkuar dhe në vitin 2013 nga ish METE, për të cilin deri më tani MZHETTS nuk ka ndonjë informacion.

Ndërsa, me urdhër të Ministrit të MZHETTS nr. 8495, datë 24.10.2016 është ngritur një grup pune me punonjës të ministrisë, me objekt “Shqyrtimin e Kontratës së Koncesionit dhe Monitorimin e kontratave të qirasë” marrë shkas nga problematikat e ngritura nga Sha “K” Vlorë.

Grupi i punës ka shqyrtuar procedurën për dhënien me koncesion të kësaj shoqërie dhe lidhjen e kontratës, ku ka arritur në konkluzionin se në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e legjislacionit për koncesionet që ka vepruar në vitet 2008-2009, kohë kur dhe është lidhur kontrata.

Për monitorimin e kontratës, është konstatuar se nga sha “K”, Vlorë si njësi monitoruese:

- nuk janë kryer kontrollat siç janë përcaktuar në pikën e kontratës”Kontrollet”,
- nuk disponohen regjistra e raporte, në të cilat të jenë shënuar hollësisht veprimet e kryera nga palët gjatë monitorimit apo kontrollit të zbatimit të kontratës,
- nuk disponohet asnjë dokumentacion për investimet e kryera.

Në përfundim, ky grup pune i ka relatuar Ministrit ngritjen në MZHETTS të Njesisë së Monitorimit të Koncesionit, për të realizuar monitorimin e kontratës, pasi njësia monitoruese aktuale nuk ka kryer asnjë veprim, por deri në përfundim të auditimit nuk është vepruar në këtë drejtim. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të rikërkojë te Titullari i ministrisë evadimin e auditimit tematik të ushtruar në sh.a “K” Vlorë, me qëllim ngritjen e Njesisë së Monitorimit të Kontratës së Koncesionit, për të realizuar monitorimin e kontratës, pasi njësia monitoruese aktuale nuk ka kryer asnjë veprim.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të bashkëpunojë me Ministrinë e Financës për përshpejtimin e procesit të inspektimit financiar të kërkuar për veprimtarinë ekonomike të sh.a “K”, Vlorë.

Menjëherë

31. Nga auditimi mbi *cilësinë e rekomandimeve*, konstatohen se; në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit Tiranë është konstatuar se, Bordi Këshillimor i DPA është mbledhur sistematikisht një herë në 3 muaj, siç përcaktohet në ligj dhe në VKM, fakt që tregon se nuk është konstatuar mangësi në mënyrën e funksionimit të bordit. Megjithatë grupi i auditimit ka rekomanduar që:

“Bordi këshillimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të mbledhet rregullisht çdo 3 muaj, si dhe të zbatohet kuorumi i pjesëmarrjes”.

Në Raportin Përfundimtar të këtij subjekti, grupi i auditimit të brendshëm nuk është shprehur për të ardhurat e realizuara nga kjo drejtori dhe respektimin e tarifave për çdo subjekt të akredituar apo riakredituar. Në konkluzionet që i janë dërguar subjektit të audituar është lënë rekomandimi: *“Të merren masa për të rishikuar tarifat përcaktuara nga Ministria e Financave”*.

Për sa më sipër, këto dy rekomandime konsiderohen formale dhe të pazbatueshëm, pasi në mungesë të mangësive të konstatuara nuk ka si të përmirësohet gjendja.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit Tiranë, një nga çështjet kryesore të këtij auditimi, ka të bëjë me vlerësimin e shërbimit të akreditimit të laboratorëve testues dhe kalibruës, organizmat certifikues dhe inspektues, si një fushë prioritare e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit që ka të bëjë me testimin e laboratorëve mjedisore.

Ndonëse kjo çështje ka përcaktuar qëllimin kryesor të këtij auditimi, por në asnjë kapitull të veçantë apo në ndonjë formë tjetër, nuk rezulton të jetë trajtuar kjo pikë si në projektraport ashtu edhe në raportin përfundimtar, fakt që tregon se grupi i auditimit nuk ka respektuar objektin kryesor të këtij programi, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Nga të dhënat e faqes zyrtare dhe të regjistrit të DPA, Grupi i Auditimit të KLSH-së konstaton se, gjatë kësaj periudhe janë akredituar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) laboratorë, nga të cilat për vitin 2013 janë akredituar gjithsej 6 laboratorë dhe për vitin 2014 janë akredituar 5 laboratorë.

Për sa më lart, ndonëse janë kryer akreditime për 11 laboratorë të ndryshëm, në raportin përfundimtar dhe në konkluzionet dërguar subjektit, nuk rezulton të jetë audituar veprimtaria dhe procedura për akreditimin e laboratorëve, duke filluar nga kërkesa e paraqitur afati 4 vjeçar për çdo subjekt të akredituar, vlerësimi i kërkesave dhe tarifat e aplikuara për këto subjekte siç përcaktohet në ligjin nr.9824, datë 01.11.2007 neni 11, “kriteret e vlerësimit dhe parametrat e konformitetit të përcaktuara”. Nga vlerësimi i këtij auditimi konstatohet se, nuk është respektuar objekti i programit të punës ku është parashikuar “Vlerësimi i efektivitetit të sistemeve, strukturave, të procedurave të kontrollit të brendshëm, sistemeve të menaxhimit financiar të fondeve publike dhe performancës së drejtorisë, në përputhje me ligjet dhe rregullat, identifikimi i mangësive dhe ndërmarrja e veprimeve korigjuese”. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në të ardhmen të tregojë kujdes të veçantë në formulimin dhe dhënien e rekomandimeve, më qëllim eliminimin e rekomandimeve të pazbatueshme e formale dhe që nuk u shërbejnë subjekteve të audituara.

Vazhdimisht

32.Nga auditimi mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit brendshëm në sistemin e MZHETTS rezultoi se, njësia për vitin 2015 dhe 2016, ka hartuar dhe dërguar në ministri deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, por në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pika 15, germa “a”, e ka dërguar atë pa informacionin e strukturave vartëse, të cilët nuk kanë paraqitur në ministri informacion për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

MZHETTS të marrë masat e duhura që, në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm buxhetor për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësonin e vetëvlerësimit, duke përfshirë dhe njësitë e vartësisë dhe njësitë e kontrolluara, me qëllim që të ndihmojë njësinë, në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtejshëm.

Vazhdimisht

33. Nga auditimi konstatohet se, njësia ka hartuar për çdo vit regjistrin e risqeve, por nuk ka hartuar strategjinë e riskut, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut (*Trajtuar më hollësisht në pikën VI të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet titullarit të institucionit të MZHETTS për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të personave konkret, nga vërejtje deri në largim nga puna.

Menjëherë

E. TË TJERA

Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e vitit 2012, ka llogaritur mungesë të ardhurash në vlerën **1,113,730,319 lekë**, detyrim që duhet paguar nga Koncesionarët e shpallur fitues. Nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve është punuar për vjeljen e tarifës për periudhën nga dalja e VKM nr. 191, datë 22.03.2012 e vazhdim, por jo që nga data 22.03.2009, periudhë që ka shtrirë efektet vendimi. Me shkresën nr. 478/25, datë 14.02.2014, i është rekomanduar subjektit të audituar, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, të bëjë rilogaritjen e vlerës tarifës, që koncesionarët duhet të paguajnë me ndryshimet e bëra me VKM nr. 191, datë 22.03.2012, të bëjë kontabilizimin dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të vitit 2013 të detyrimeve për këtë tarifë (të analizuar sipas viteve 2012-2013), rekomandim i cili jo vetëm nuk është zbatuar nga ky institucion, por nuk i është përcjellë për veprime të mëtejshme ATRAKO-s, e për pasojë në kontabilitetin e Agjencisë nuk rezultojnë të regjistruara këto detyrime të mbartura të koncesionarëve ndaj saj.

Po kështu, nga auditimi i ushtruar nga KLSH në vitin 2015, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar dhe vendimmarrjes në marrëveshjet koncensionare”, të ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 140, datë 30.09.2015, është konstatuar moszbatimi i rekomandimit të mësipërm. Me shkresën nr.118/12, datë 12.10.2015 është rikërkuar nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë që të marri masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimit.

Përgjatë viteve 2012 dhe 2013, referuar akt rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë, janë arkëtuar tarifa koncensionare në shumën **63,766,686 lekë**, pra mbeten detyrime të pa shlyera nga shoqëritë koncensionare në shumën **1,049,963,633 lekë**. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e KLSH-it ti kërkohet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, që materialet e auditimit të ushtruar në këtë institucion për koncesionet, në vitet 2012, 2013 dhe 2015 dhe masat e marra nga ky institucion për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ti dërgohen zyrtarisht ATRAKO-s dhe MZHETTS, me qëllim evidentimin në kontabilitetin e tyre të detyrimeve të përlllogaritura të koncensionarëve dhe arkëtimin e tyre (Krahas rekomandimit të dhënë në pikën, C.26 të këtij Vendimi).

Menjëherë

F.ADRESIM PËR USHTRIM AUDITIMI PERFORMANCE NË TË ARDHMEN

Nisur nga rezultatet e konstatuara në përfundim të këtij misioni auditues të ushtruar në MZHETTS, të merren masat që Raporti Përfundimtar i Auditimit si dhe ky Vendim ti adresohen Departamentit të Auditimit të Performancës pranë KLSH-it për analizimin e mëtejshëm me qëllim ideimin e një apo disa misioneve audituese performance në fushat respektive të veprimtarisë së MZHETTS.

Menjëherë

G.PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

Bazuar në nenin 15, germa “l” dhe në germën “ç” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin e Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit të merren masa që një kopje e Raportit Përfundimtar të këtij auditimi si dhe të këtij Vendimi ti paraqiten Komisionit të Ekonomisë, Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë pas konstituimit të tij mbi bazën e zgjedhjeve të përgjithshme që do të zhvillohen përgjatë muajit qershor të vitit 2017.

Menjëherë pas konstituimit të Kuvendit

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Punoi: M.Kvaja

Pranoi: A.Agolli